



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Kryeministri

U R D H Ë R

Nr. 165, datë 27.7.2006

PËR

**NGRITJEN E GRUPIT NDËRMINISTROR TË PUNËS,
PËRGJEGJËS PËR PËRGATITJEN, HARTIMIN DHE NDJEKJEN E
ZBATIMIT TË STRATEGJISË NDËRSEKTORIALE TË
ZHVILLIMIT RURAL, NË KUADËR TË STRATEGJISË
KOMBËTARE PËR ZHVILLIM DHE INTEGRIM**

Në mbështetje të nenit 102, të Kushtetutës dhe të vendimit nr.692, datë 10.11.2005, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e strategjisë “Konsolidimi i një sistemi planifikimi të integruar në Shqipëri””,

U R D H Ë R O J :

1. Ngritjen e grupit ndërministror të punës, përgjegjës për përgatitjen, hartimin dhe ndjekjen e zbatimit të strategjisë ndërsektoriale të zhvillimit rural.
2. Ky grup pune të kryesohet nga zëvendëskryeministri dhe në përbërje të ketë këta anëtarë:
 - Ministrin e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit;
 - Zëvendësministrin e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës;

- Zëvendësministrin e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave;
 - Zëvendësministrin e Financave;
 - Zëvendësministrin e Brendshëm;
 - Zëvendësministrin e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit;
 - Zëvendësministrin e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve;
 - Zëvendësministrin e Arsimit dhe Shkencës;
 - Zëvendësministrin e Shëndetësisë.
3. Në mbledhjet e grupit të punës, në varësi të çështjeve, që do të diskutohen, thirren të marrin pjesë:
- titullarët e institucioneve, në varësi të ministrive pjesëmarrëse, që do të përfshihen në hartimin e strategjisë së zhvillimit rural;
 - ekspertë nga Ministria e Financave dhe Ministria e Integritit;
 - përfaqësues nga Departamenti i Bashkërendimit të Strategjive dhe Koordinimit Strategjik të Ndhmës së Huaj.
4. Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit vepron si koordinator ndërmjet këtij grupi pune dhe Departamentit të Bashkërendimit të Strategjive dhe Koordinimit Strategjik të Ndhmës së Huaj, si dhe Ministrisë së Financave e Ministrisë së Integritit.
5. Zëvendëskryeministri ngarkon me detyrën e sekretariatit teknik punonjësin ose njësinë, që siguron mbështetje, teknike dhe logjistike, për grupin ndërministror të punës.
6. Ministri i Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, me propozimin e grupit ndërministror të punës, krijon një grup teknik pune, me ekspertë në nivel drejtori ose specialistësh të lartë, nga ministrinë pjesëmarrëse, të kryesuar nga zëvendësministri i Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit.
7. Për përgatitjen, hartimin dhe ndjekjen e zbatimit të strategjisë ndërsektoriale të zhvillimit rural zbatohen udhëzimet e përcaktuara në aneksin 1, që i bashkëlidhet këtij urdhri, dhe manuali “Për përgatitjen e strategjisë kombëtare për zhvillim dhe integrim, strategjive,

sektoriale dhe ndërsektoriale”, që i bashkëlidhet urdhrit nr.134, datë 12.6.2006, të Kryeministrit.

8. Funkzioni, rregullat e funksionimit dhe detyrat e grupit ndërministror të punës dhe të grupit teknik përcaktohen me urdhër të zëvendëskryeministrit, në përputhje me aneksin 1, që i bashkëlidhet këtij urdhri.
9. Ngarkohet ministri i Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, që, brenda 5 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij urdhri, të sigurojë fillimin e veprimtarisë së grupit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI



SALI BERISHA